

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1237/22

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 04.10.2022

VUŠTTRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
MPB - POLICIA E KOSOVËS - MUP - POLICIJA KOSOVA - MIA - KOSOVO POLICE

DREJTORI RAJONAL - MITROVICË-JUG - REGIONALNI DIREKTOR - MITROVICA-JUG  
REGIONAL DIRECTOR - MITROVICA-SOUTH

Nr./Br./No. 23/2022 Nr. fl./Br.str./No.pg. 03

Data/Datum/Date 04.10.2022  
Mitrovicë Jug - Mitrovica Jug - Mitrovica South

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo



**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



**Policia e Kosovës**  
Policija Kosova - Police Kosovo

Duke u bazuar në nenin 8 Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe me ato lokale të qeverisjes dhe nenit 25 vëzhgimi parandalues i vendeve publike të Ligjit Nr. 04/L-076 për policin, si dhe në nenin 58 shkronja “a” dhe “m” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 04/L-040, nenin 67 shkronja “g” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë më rëndësinë dhe nevojën e bashkëpunimit në mes tyre dhe avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve reciproke, roli dhe qëllimi i këtyre institucione është ofrimi i sigurisë publike për qytetaret e kësaj komune duke shprehur interesimi për bashkëpunim me qëllim të rritjes së sigurisë së qytetarëve dhe pronës, lidhet kjo:

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të

### KOMUNËS SË VUSHTRRISË DHE POLICISË SË KOSOVËS

#### Neni 1 PALËT

- I. Komuna e Vushtrrisë (më tutje Komuna) adresa Sheshi “Ahmet Krasniqi” nr. 10, i përfaqësuar nga z. Ferit IDRIZI, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë apo i autorizuari i tij;
- II. Policia e Kosovës (më tutje PK-ja) adresa në Rr. “Luan Haradinaj” Nr. 101 Prishtinë, i përfaqësuar nga z. Fehmi HOTI, U/D Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës apo i autorizuari i tij.

#### Neni 2 QËLLIMI

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është ngritja e bashkëpunimit në sigurinë publike dhe koordinimi institucional i aktiviteteve përmes sistemit të kamerave të vendosura në territorin e Komunës së Vushtrrisë për sigurinë në rrugë dhe hapësirat publike.

### **Neni 3**

#### **OBJEKTIVA**

Objektivë kryesore e lidhjes së kësaj marrëveshje është bartja në mbajtje dhe menaxhim në Stacionin Policor në Vushtrri të pajisjeve qendrore të rrjetit të sistemit të kamerave të Komunës së Vushtrrisë të cilat ndodhen në objektin e komunës për përmirësimin e sigurisë në hapësirat publike.

### **Neni 4**

#### **OBLIGIMET E KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

- 4.1 Komuna ia bartë në afat të pacaktuar në mbajtje dhe menaxhim Policisë së Kosovës pajisjet qendrore përkatësisht sistemin e instaluar të kamerave në hapësirat publike që funksionojnë në territorin e saj;
- 4.2 Komuna mban të drejtën e pronësisë së këtij sistemi të kamerave dhe do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe avancimin e tij;
- 4.3 Komuna, përveç për nevoja praktike (si për shembull për çështjet e mobilitetit), nuk do të ketë qasje në sistemin ose në të dhënat e mbikëqyrjes me kamera në vende publike në përputhje me vendimet e Agjencionit për Informacione dhe Privatësi;
- 4.4 Shpenzimet e zhvendosjes nga objekti i komunës së Vushtrrisë përkatësisht bartjes si dhe mirëmbajtjes të pajisjeve të cekur si në pikën paraprake i bartë Komuna.

### **Neni 5**

#### **OBLIGIMET E POLICISË SË KOSOVËS**

- 5.1 PK-ja duhet të pranoj bazën për monitorimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave nga vëzhgimi me kamera në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
- 5.2 PK-ja obligohet që të veproj sipas autorizimeve, që të bëjë vëzhgimin parandalues në vendet publike siç parashihet me ligj për përpunimin e të dhënave personale;
- 5.3 PK-ja merr përsipër që të bashkëpunoj dhe koordinohet me Komunën në mirëmbajtjen e sistemit të kamerave;
- 5.4 PK-ja obligohet që në bashkëpunim me menaxherin e projektit të cilin e cakton komuna të koordinoj aktivitetet në lidhje me bashkëpunimin me operatorin ekonomik që përzgjidhet për mirëmbajtjen e kamerave;
- 5.5 PK-ja obligohet që në bashkëpunim me operatorin ekonomik të përzgjedhur të mbroj të dhënat që mos t'u bien në dorë personave të pa autorizuar.

**Neni 6**  
**MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

Informatat e pranuar gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje duhet të trajtohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 7**  
**MOSMARRËVESHJET EVENTUALE**

Komuna dhe PK-ja, pajtohen se për çdo mosmarrëveshje apo keqinterpretim lidhur me natyrën dhe qëllimin e bashkëpunimit që del nga kjo Marrëveshje do ta zgjedhin përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore.

**Neni 8**  
**VLEFSHËMIRA KOHORE E MARRËVESHJES**

Palët nënshkruese pajtohen që vlefshmëria kohore e kësaj marrëveshje të jetë në afat të pa caktuar, ndryshim-plotësimi apo prishja e kësaj marrëveshje, mund të bëhet në çdo kohë vetëm me kërkesë me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë me arsyetim paraprak të parashtruar nga palë nënshkruese.

**Neni 9**  
**HYRJA NË FUQI**

Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale (nga një kopje në gjuhën shqipe dhe serbe) për secilën palë nënshkruese dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

Nënshkruar me datë: 04.10.2022 në: Vushtrri

**PËR: KOMUNËN**

**z. Ferit DRIZI, Kryetar**  
Kryetar i Komunës Vushtrri

  
(nënshkrim dhe vula)



**PËR: PK-në**

**Kolonel Afërdita MIKULLOVCI**  
Drejtore Rajonale e Policisë, DRP Mitrovicë Jug

  
(nënshkrim dhe vula)



0112  
06/10/2022